



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-150**

**PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj themelohen Odat e profesionistëve shëndetësorë si organizata të pavarura profesionale që ushtojnë veprimtari publike, rregullohet anëtarësia në Oda, kompetencat e Odave, organizimi dhe funksionimi i Odave, mbajtja e regjistrit të anëtarëve të Odave, organet e Odave, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të Odave, burimet e financimit të Odave dhe çështjet tjera me rëndësi për punë dhe funksionim të Odave.

**Neni 2**

1. Odat e profesionistëve shëndetësorë në Republikën e Kosovës janë organizata të pavarura të cilat mbrojnë dhe prezantojnë interesat profesionale të anëtarëve të saj, sigurojnë standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovojnë dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private,

sigurojnë edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

2. Për ushtrimin e këtij misioni dhe përgjegjësi formohen;

- 2.1. Oda e mjekëve;
- 2.2. Oda e stomatologëve;
- 2.3. Oda e farmacistëve;
- 2.4. Oda e fizioterapeutëve; dhe
- 2.5. Oda e infermiereve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

### **Neni 3**

#### **Qëllimi i themelimit të Odave të profesionistëve shëndetësor**

1. Odat e profesionistëve shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm: Odat) do të themelohen në mënyrë që të:

- 1.1. japin profesionistëve shëndetësor pavarësinë profesionale;
- 1.2. sigurojnë organizata profesionale të vetëqeverisura;
- 1.3. kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në përgjithësi;
- 1.4. krijojnë kushtet për ushtrimin e profesionit të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, infermierëve dhe mamive, fizioterapeutëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor;
- 1.5. mbrojnë interesat e tyre profesionale, sociale dhe ekonomike;
- 1.6. japin konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët;
- 1.7. promovojnë standardet e larta të sjelljes profesionale;
- 1.8. promovojnë interesat e pacientëve për kujdesin shëndetësor;
- 1.9. kryejnë lehtësime për ushtrimin e aktiviteteve profesionale;
- 1.10. promovojnë dhe mbrojnë aktivitetet e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike dhe private;
- 1.11. zhvillojnë dhe të zbatojnë programe të shkollimit specialistik pasuniversitare dhe proceseve për të siguruar cilësi të lartë të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera që lidhen me kujdesin shëndetësor;

1.12. promovojnë dhe kryejnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe proceset e të mësuarit afatgjatë;

1.13. organizojnë pjesëmarrjen në përmirësimin dhe zbatimin e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjen e interesave të pacientëve në ushtrimin e të drejtës së tyre për kujdesin shëndetësor;

1.14. marrin pjesë në krijimin e parimeve shëndetësore dhe zhvillimin e kujdesit shëndetësor dhe të japin këshilla për ata që konsiderohen përgjegjës për formulimin e parimeve shëndetësore dhe zbatimin e tyre.

#### **Neni 4 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.2. **Ministria** - Ministria e Shëndetësisë;

1.3. **Qytetari** - personi me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Shtetësinë e Kosovës, ose personi i kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin;

1.4. **Shfrytëzuesi i shërbimeve shëndetësore** - personi i cili i shfrytëzon shërbimet shëndetësore;

1.5. **Agjensioni i Financimit Shëndetësor (AFSH)** - agjencion ekzekutiv i Ministrisë që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin, blerjen, e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si dhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare për këtë qëllim.

1.6. **Lista e barërave dhe materialit shpenzues** - Lista e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese që mbulohen nga Qeveria dhe bashkë-pagesat e qytetarëve;

1.7. **Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor** - Lista e formave dhe llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Qeveria dhe nga bashkë-pagesat (përfshirë Listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese) e cila përpilohet nga komiteti teknik i emëruar nga Ministria.

1.8. **Profesionisti shëndetësor** - punëtori që ofron shërbime shëndetësore;

1.9. **I diplomuar** - personi që ka përfunduar studimet themelore universitare;

1.10. **Specialist** - kualifikimi profesional i fituar gjatë shkollimit specialistik pasdiplomik, të kryer në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar në pajtim me këtë ligj;

1.11. **Sub-specialist** - kualifikimi i ngushtë profesional i fituar gjatë shkollimit pas specialistik në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar nga organi i autorizuar ose i njohur në pajtim me këtë ligj;

1.12. **Bashkëpunëtori shëndetësor** - personi i cili nuk e ka kryer shkollimin formal medicinal, që me qëllim të realizimit të veprimtarisë shëndetësore është i punësuar në institucion shëndetësor;

1.13. **Kujdesi shëndetësor** - masat dhe veprimet që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësor, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe të banorëve;

1.14. **Shërbimi profesional** - organizimi administrativ dhe profesional i institucioneve shëndetësore brenda një lëmie specialistike, që ka për qëllim sigurimin e vazhdimësisë së kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e organizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

1.15. **Institucioni shëndetësor** - institucioni i themeluar nga personi juridik ose fizik që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor, në bazë të licencës së lëshuar në pajtim me këtë ligj;

1.16. **Fshehtësia profesionale** - ruajtja e të dhënave për gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore nga qasja në to prej personave të paaautorizuar.

## **Neni 5** **Statusi ligjor i Odave**

1. Odat janë organizata të pavarura profesionale që ushtrojnë veprimtari publike dhe kanë cilësinë e personit juridik, me të drejta dhe detyra të përcaktuara me këtë ligj, aktet nënligjore, legjislacionin tjetër përkatës dhe Statutin e Odave.

2. Odat do të kenë selinë e vet në Prishtinë dhe nuk do të kenë zyra të degëve.

3. Secila Odë do të veprojë në emër të vetë dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet e veta me të gjitha pasuritë e tyre.

4. Odat do të miratojnë statutet për organizimin dhe funksionimin e brendshëm, përfaqësimin, kompetencat dhe përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, dispozitat themelore për zgjedhjet dhe emërimet, çështjet financiare, përgjegjësi disiplinore dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e tyre.

## **Neni 6** **Atributet e Odave**

Secila Odë duhet të ketë vulën e vet, simbolet dhe atributet e tjera duke i bërë ato publikisht të njohura. Atributet do të përcaktohen më tej në statutet e tyre.

## **Neni 7**

1. Veprimtaria e Odave është transparente.
2. Transparenca e punës së Odave sigurohet në harmoni me këtë ligj, me ligjet tjera dhe statutin e Odës.

## **KREU II ANËTARËSIMI NË ODA**

### **Neni 8**

1. Anëtarësimi në Oda është i detyrueshëm për të gjithë doktorët e mjekësisë, doktorët e stomatologjisë, farmacistet e diplomuar, infermierët e diplomuar, mamitë e diplomuara, fizioterapeutët e diplomuar, laborantët e lartë mjekësorë, logopedët e diplomuar, foniatët e diplomuar, psikologët klinikë, profesionistët tjerë shëndetësor me kualifikim të mesëm dhe të lartë të përcaktuar në regjistrin zyrtarë të ministrisë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre shëndetësore në Republikën e Kosovës.
2. Anëtarësimi në Oda është detyrueshëm edhe për profesionistët shëndetësorë nga paragrafi 1. i këtij neni të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale, institucione tjera të organeve shtetërore, në fakultete, gjegjësisht në shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës si dhe në të gjitha rrethanat tjera ku ushtrohet veprimtaria shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.

## **KREU III KOMPETENCAT E ODAVE**

### **Neni 9 Kompetencat publike të Odave**

1. Kompetencat publike të Odës janë:
  - 1.1. miraton kodin e etikës profesionale (kodin e etikës);
  - 1.2. regjistron dhe mirëmban regjistrin e profesionistëve dhe bashkpunëtorëve shëndetësor dhe mban regjistrin e të gjitha Institucioneve shëndetësore;
  - 1.3. lëshimi i licencave, ri-licencimi dhe revokimi i tyre;
  - 1.4. zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhim të eksperteve të lëmive përkatëse;

- 1.5. bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
- 1.6. ushtrojnë mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësor;
- 1.7. verifikon ligjshmërinë e procesit të specializimit, organizon provimin specialistik, organizon dhe mbikëqyr sub-specializimet;
- 1.8. planifikojnë, zbatojnë edukimin e vazhdueshëm profesional;
- 1.9. ndërmjetëson në kontestet në mes anëtarëve të Odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;
- 1.10. organizon gjyqet e nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të Odave dhe shqipton masa disiplinore;
- 1.11. cakton lartësinë e pagesës së anëtarësisë të anëtarëve të Odave;
- 1.12. cakton lartësinë e taksës për licencim, ri-licencimit, dhe lejeve tjera për ushtrim të veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;
- 1.13. lëshon kartelat e identifikimit dhe numrat identifikues për anëtarët e Odave;
- 1.14. me kërkesën e anëtarëve të Odës lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të Odës.

## **Neni 10**

### **Kompetencat tjera të Odave**

1. Përveç autorizimeve publike nga neni 9 i këtij ligji Odat ushtrojnë edhe këto punë:
  - 1.1. përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve të Odës në ushtrimin e profesionit;
  - 1.2. kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të Odave në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;
  - 1.3. mban evidencën e anëtarëve të Odave që ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore dhe të cilit janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetentë në pajtim me ligjin;
  - 1.4. bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
  - 1.5. bashkëpunimi në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve si dhe akteve tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;

- 1.6. propozimi dhe inicimi i procedurave për nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet tjera të Odës;
- 1.7. bashkëpunimi në përcaktimin e çmimoreve të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve farmaceutike, në bashkëpunim me fondin e sigurimeve shëndetësore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;
- 1.8. bashkëpunimi në përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse;
- 1.9. bashkëpunimi në përpilimin e plan-programeve për edukimin e vazhdueshëm profesional për të gjithë profesionistët shëndetësorë;
- 1.10. zbatimi i aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Odës;
- 1.11. përfaqësimi i interesave profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve tjerë;
- 1.12. konsultimi, ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimi i interesave të anëtarëve në fushën e legjislacionit si dhe lëmive tjera që ndërlidhen me fushën e shëndetësisë;
- 1.13. pjesëmarrja në vendimmarrje në lidhjen e kontratave me fondin për sigurime shëndetësore;
- 1.14. krijimi dhe menaxhimi i fondit të Odës;
- 1.15. bashkëpunimi me institucione përkatëse në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale;
- 1.16. përgatitja dhe lëshimi i formave dhe dokumenteve si dhe i revistave, librave dhe publikimeve tjera;
- 1.17. promovimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të Odës;
- 1.18. promovimi dhe zbatimi i aktiviteteve kulturore dhe shoqërore të anëtarëve, organizimi i ngjarjeve kulturore, sportive dhe ngjarje të tjera sociale;
- 1.19. emërimi i përfaqësuesve të Odës në marrëveshje me institucionet e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor;
- 1.20. zhvillimi i aktiviteteve tjera në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës.

## **KREU IV REGJISTRIMI I PROFESIONISTEVE SHËNDETËSOR**

### **Neni 11**

1. Odat e profesionisteve shëndetësore ne pajtim me këtë ligj mbajnë këto regjistra te Odes:

- 1.1. regjistri i të gjithë anëtareve te Odes;
- 1.2. regjistri i licencave te lëshuar dhe te revokuara;
- 1.3. regjistri i masave te shqiptuara disiplinore anëtareve te Odave.

### **Neni 12**

1. Organet kompetente te Odave te profesionisteve shëndetësore ne afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes se kërkesës nga profesionistet shëndetësore me vendim lejojnë regjistrimin ne regjistrin e profesionistit shëndetësore.

2. Ndaj vendimit nga paragrafi 1. i këtij neni mund te ushtrohet ankesa organit kompetente ne afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e nxjerrjes se vendimit.

### **Neni 13**

Anëtarët e Odave te profesionisteve shëndetësore obligohen qe organit kompetente të Odes ti paraqesin çdo ndryshim me rëndësi për regjistrim nga neni 11 i këtij ligji si dhe fakte tjera te rëndësishme në kompetencë të Odës më së largu tridhjetë (30) ditë nga dita e informimit për ndryshime respektivisht fakte te reja.

### **Neni 14**

Regjistrat nga neni 11 i këtij ligji janë dokumente publike.

### **Neni 15**

Odat me akte te veçanta përcaktojnë mënyrën e regjistrimit, evidentimit dhe mirëmbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e regjistrave si dhe formën e shkresave, vërtetimeve dhe akteve tjera të Odës në bazë të evidencës zyrtare.



## **KREU V ORGANET E ODAVE**

### **Neni 16**

1. Organet e Odave janë:

- 1.1. Kuvendi;
- 1.2. Kryetari i Odës;
- 1.3. Këshilli drejtues;
- 1.4. Këshilli mbikëqyrës për buxhet dhe financa;
- 1.5. Këshilli etik;
- 1.6. Gjyqi i nderit;
- 1.7. Prokurori i Odës;
- 1.8. Komisionet e përhershme të Odës.

2. Anëtarët e kuvendit të Odave zgjidhen për mandat katër (4) vjeçar.

3. Anëtarët e kuvendit të Odave mund të zgjidhen sërish pas skadimit të mandatit edhe për një mandatë katër (4) vjeçare.

4. Autorizimet, kompetencat dhe mënyra e punës të organeve nga paragrafi 1. i këtij neni më për së afërmi rregullohen me statut.

### **Neni 17**

Kryetari i Odës, zëvendës Kryetarët, anëtarët e këshillit drejtues dhe sekretari i përgjithshëm nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe ne mësimdhënie.

### **Neni 18**

Organet nga neni 11 i këtij ligji në përbërjen e vetë duhet të sigurojnë përfaqësimin e barabartë të të gjithave nivelit të organizimit funksional dhe profesional.

## **Neni 19**

### **Kompetencat e Kuvendit**

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës, i cili ka këto përgjegjësi dhe autorizime:
  - 1.1. miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe aktet e tjera normative;
  - 1.2. miraton kodin e etikës profesionale;
  - 1.3. miraton programin e punës së Odës;
  - 1.4. miraton rregulloren e punës së Odës;
  - 1.5. zgjedh dhe shkarkon kryetarin;
  - 1.6. miraton dhe shkarkon anëtarët e këshillit drejtues të Odës;
  - 1.7. zgjedh dhe shkarkon kryetarin, zëvendës kryetarin dhe anëtarët e këshillit etikë;
  - 1.8. zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës;
  - 1.9. zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e gjyqit të nderit;
  - 1.10. zgjedh dhe shkarkon prokurorin e Odës;
  - 1.11. zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të përhershme të Odës;
  - 1.12. përcakton lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e Odës;
  - 1.13. përcakton lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e Odës, taksën për licencim dhe rilicencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare;
  - 1.14. shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të Odës;
  - 1.15. miraton raportin financiarë dhe llogarinë përfundimtare të Odës;
  - 1.16. merr vendim për shkarkim të kuvendit të Odës dhe shpall zgjedhjet e parakohshme;
  - 1.17. shqyrton dhe merr qëndrime parimore për çështjet me rëndësi për punën e Odës;
  - 1.18. kryen dhe punë të tjera të parapara me statutin e Odës.

## **Neni 20** **Kryetari i Odës**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të Odës:
  - 1.1. përfaqëson Odën dhe vepron në emër të saj;
  - 1.2. fton dhe udhëheq seancat e kuvendit;
  - 1.3. ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të Odës;
  - 1.4. ekzekuton aktet e kuvendit të Odës;
  - 1.5. i propozon kuvendit të Odës emërimin dhe shkarkimin e zëvendësve të tijë/sajë.
  - 1.6. organizon punën dhe drejton politikën e Odës;
  - 1.7. propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin Odës;
  - 1.8. raporton para kuvendit të Odës për situatën ekonomiko-financiare të Odës, së paku njëherë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Odës;
  - 1.9. kryen aktivitetet tjera që i caktohen me statut.
2. Në rast mungese kryetarin e Odës e zëvendëson njëri nga zëvendësit e kryetarit e Odës.

## **Neni 21** **Këshilli drejtues i Odës**

1. Këshilli drejtues i Odës:
  - 1.1. është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Odës;
  - 1.2. përcakton propozimin e statutit dhe akteve tjera të Odës;
  - 1.3. propozon kuvendit anëtarët e organeve të Odës;
  - 1.4. përcjell dhe harmonizon, punën e organeve të Odës;
  - 1.5. përcakton propozimin e programit të punës të Odës;
  - 1.6. propozon organeve shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësore;
  - 1.7. përcakton planin financiarë të Odës dhe kujdeset për zbatimin;
  - 1.8. miraton llogaritë periodike financiare;

- 1.9. emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm të Odave;
- 1.10. shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së Odave në fushat për të cilat është përgjegjëse;
- 1.11. miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizim e punëve të shërbimit profesional të Odës dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës të shërbimit profesional;
- 1.12. vendos në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të Odës;
- 1.13. kryen dhe punë tjera të parapara me statut të Odës.

## **Neni 22**

1. Këshilli drejtues i Odës ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë, nga të cilët një (1) anëtarë i komunitetit jo shumicë dhe një (1) anëtarë nga radhët e komuniteteve tjera.
2. Kryetari dhe zëvendës kryetarët e Odës janë anëtarë të këshillit drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Pesë (5) anëtarë të këshillit drejtues i zgjedh kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të vetë, ndërsa tre (3) anëtarë të këshillit drejtues i delegon Ministria e Shëndetësisë.
4. Mënyra e punës së këshillit drejtues më hollësisht rregullohet me statut.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Odës është person i ftuar gjithmonë në takimet e Këshillit drejtues.
6. Sekretari i Përgjithshëm i Odës nuk ka të drejtë vote por ka të drejtë për të propozuar pika në rendin e ditës dhe dokumentet mbështetëse të tyre.

## **Neni 23**

### **Këshilli mbikëqyrës i Odës**

1. Këshilli mbikëqyrës i Odës:
  - 1.1. mbikëqyrë dhe përcjellë afarizmin financiarë të Odës;
  - 1.2. përcjellë dhe mbikëqyrë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të Odës;
  - 1.3. mbikëqyrë dhe përcjellë punën e shërbimit profesional të Odës;
  - 1.4. propozon këshillit drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve të miratuar nga kuvendi i Odës;

- 1.5. kryen dhe punë tjera të parapara me statut dhe me akte tjera të Odës.
2. Këshilli mbikëqyrës i Odës përbëhet nga shtatë (7) anëtarë.
3. Kryetarin , zëvendës Kryetarin dhe tre (3) anëtarë tjerë të këshillit i zgjedh kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të vetë, ndërsa dy (2) anëtarë i delegon Ministria e Shëndetësisë.
4. Këshilli mbikëqyrës i Odës për punën e vetë i përgjigjet kuvendit të Odës.

## **Neni 24** **Këshilli etik**

### 1. Këshilli etik:

- 1.1. mbikëqyr zbatimin e kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore;
- 1.2. siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike dhe promovon principet dhe parimet të etikës profesionale;
- 1.3. merr masat e duhura në rast të shkeljes së kodit etik dhe të deontologjisë mjekësore;
- 1.4. pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
- 1.5. jep mendimet dhe vlerësimet për punën e anëtarëve të Odës në pajtim me kodin e etikës profesionale;
- 1.6. i ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e së drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së shërbimeve;
- 1.7. kryen dhe punë tjera të parapara me statut të Odës si dhe me akte të veçanta të Odës.
- 1.8. këshilli etikë ka pesë (5) anëtarë;
  - 1.8.1. Kryetarin, zëvendës kryetarin dhe dy (2) anëtarët e tjerë të këshillit etikë i zgjedh kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të vet, ndërsa një (1) anëtarë e delegon Ministria e shëndetësisë.

## **KREU VI MASAT DISCIPLINORE**

### **Neni 25**

1. Këshilli etik është organ i shkallës së parë i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë të profesionistëve shëndetësor për shkelje të këtij ligji, statutit të Odës dhe kodit të etikës mjekësore dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa disiplinore:

- 1.1. rekomandim kolegjial;
- 1.2. kërkim falje ndaj pacientit;
- 1.3. qortim ose qortim publik;
- 1.4. arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
- 1.5. trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
- 1.6. tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;
- 1.7. dënimi me të holla njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

### **Neni 26**

1. Në procedurë para Këshillit Etik të Odës, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, në lidhje me thirrjen e palëve, sigurimin e provave, dëgjimin e palëve, përgatitjen e procesverbaleve dhe procedurat tjera.

2. Anëtari i Odës ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë këshillit etik.

3. Në procedure e marrjes në pyetje të anëtarëve të Odës dhe vlerësimit të provave në procedure disiplinore para këshillit etik mbahet procesverbali.

4. Sipas ankesës ndaj vendimit të këshillit etikë vendos gjyqi i nderit.

### **Neni 27**

Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për përcaktimi e shkeljeve të anëtarit të Odes nga nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6., dhe 1.7. të paragrafit 1. të nenit 25 të këtij ligji nuk mund të filloj pas skadimit të një (1) viti nga dita e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të Odës.

## **KREU VII GJYQI I NDERIT**

### **Neni 28**

1. Gjyqi nderit ka (5) pesë anëtarë, Kryetarin, zëvendësin e tij dhe tre (3) anëtarë të zgjedhur nga kuvendi i Odës.
2. Një (1) anëtarë dhe zëvendësin e tij e propozon Këshilli Gjyqësorë i Kosovës.

### **Neni 29**

Gjyqi i nderit vendosë edhe lidhur me ankesat e anëtarëve, qytetarëve dhe parregullsive ne procesin e zgjedhjeve të organeve të Odës.

### **Neni 30**

Ndaj vendimit përfundimtar me të cilën është shqiptuar masa disiplinore nga nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6., dhe 1.7. të paragrafit 1. të nenit 25 të këtij ligji profesionistët shëndetësorë mund të ushtrojnë ankesë pranë gjykatës së nderit të profesionistëve shëndetësorë.

## **KREU VIII PROKURORI I ODES**

### **Neni 31**

Prokurori i Odës është organ i pavarur për inicimin e procedurës ndaj anëtarëve të Odës ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar se ka bërë shkelje të ligjit, statutit dhe kodit të etikës mjekësore.

### **Neni 32**

Rastet e shkeljes nga neni 25 i këtij ligji mund ti denoncojnë: Oda e profesionisteve Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë, Shoqatat e Profesionisteve Shëndetësor, Institucionet Shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e Odës dhe pala e dëmtuar.

### **Neni 33**

1. Prokurorin edhe zëvendësin e tij e zgjedhë Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës.
2. Prokurori i Odës për punën e vetë i përgjigjet Kuvendit të Odës.

## **KREU IX KOMISIONET E PËRHERSHME TË ODËS**

### **Neni 34**

Odat e profesionistëve shëndetësorë kanë komisionet e përhershme dhe të përkohshme. Anëtarët e komisioneve të Kuvendeve të Odës i zgjedh kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës.

### **Neni 35**

1. Komisionet e përhershme të Odës janë :
  - 1.1. Komisioni për çështje etike;
  - 1.2. Komisioni për licencim të profesionistëve shëndetësor;
  - 1.3. Komisioni për edukim specialistik;
  - 1.4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
  - 1.5. Komisioni për buxhet dhe financa;
  - 1.6. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

### **Neni 36**

Përbërja dhe fushëveprimi i komisionit nga neni 35 i këtij ligji përcaktohen me statut dhe akte të tjera normative të Odës.

### **Neni 37**

1. Kuvendi i Odës sipas nevojës mund të formoj edhe komisione tjera të përkohshme.
2. Me vendim për formimin e komisionit të përkohshëm kuvendi i Odës përcakton përbërjen dhe fushëveprimin e komisionit të përkohshëm.



## **KREU X**

### **BURIMET E FINANCIMIT TË ODËS**

#### **Neni 38**

1. Mjetet për themelimin dhe funksionimin e Odës sigurohen nga:

1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës për fazën kalimtare tre (3) vjeçare.

1.2. mjetet e realizuara sipas nenit 39 të këtij ligji, për tri (3) vitet e para nga hyrja në fuqi e këtij ligji, derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 39**

1. Odat e profesionistëve shëndetësorë realizojnë të hyra vetanake nga:

1.1. anëtarësia;

1.2. taksa për licencim dhe ri-licencim si dhe lartësia e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare;

1.3. dhuratat dhe donacionet e tjera si dhe të hyrat tjera në pajtim me ligjin.

#### **Neni 40**

1. Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, kompensimin për regjistrim, licencim dhe shërbime të tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet tjera normative të Odës.

2. Në rast dështimi të përmbushjes së këtyre obligimeve organet e Odës marrin masa disiplinore ndaj anëtarëve të sajë.

#### **Neni 41**

1. Mjetet e Odës derdhen në xhirrologarinë e Odës dhe menaxhohen si në vijim:

1.1. për tri (3) vitet e para kalimtare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, mjetet sigurohen nga Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

1.2. të hyrat e parapara për financim të Odës sipas nenit 39 të këtij ligji fillojnë të zbatohen me themelimin e Odës në pajtim me këtë ligj dhe për tri (3) vitet e para derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Mjetet e grumbulluara në vitin e tretë mbahen në Buxhetin e Republikës së Kosovës si mjete të alokuara për Odën sipas

Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, të cilat derdhen në xhirollogarinë e Odës me fillimin e vitit të katërt me qëllim të funksionimit të Odës.

- 1.3. pas vitit të tretë, Oda vetëfinancohet sipas mënyrës së paraparë me këtë ligj.
2. Oda e ka xhirollogarinë e vetë të hapur nga Thesari.
3. Kryetari i Odës është përgjegjës financiar i Odës.
4. Oda është përgjegjëse për punën e saj me tërë pasurinë që disponon.

#### **Neni 42**

Oda hap llogari të veçantë, menaxhon mjetet e dedikuara në fondin e solidaritetit dhe ndihmës reciproke të anëtarëve të Odës.

### **KREU XI TRANSPARENCA E PUNES SE ODAVE**

#### **Neni 43**

1. Odat e profesionisteve shëndetësore obligohen që të njoftojnë opinionin mbi çështjet e rëndësishme nga fushëveprimi i Odave.
2. Odat kanë për obligim të njoftojnë organet kompetente të ndjekjes, organet kompetente të gjyqësorë dhe Ministrin përkatëse për Shëndetësi për procedure disiplinore që udhëhiqet ndaj anëtarëve të Odës nga organet e Odës si dhe procedurën e licencimit, rilicencimit dhe revokimit të licencës nëse dyshohet se në këto procedura ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepër penale.
3. Odat kanë për obligim që me kërkesë të organeve nga paragrafi 2. i këtij neni t'i vejë në dispozitim të gjitha faktet dhe informatat që posedon.

#### **Neni 44**

Odat bashkëpunojnë me institucionet arsimore të profilit shëndetësorë, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësorë, fondet e sigurimeve shëndetësore lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e Odës dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

## **KREU XII**

### **MBIKËQYRJA E PUNËS SË ODËS**

#### **Neni 45**

1. Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së Odës në ushtrimin e funksioneve publike nga neni 9 i këtij ligji e bënë Ministria për Shëndetësi.
2. Në ushtrimin e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni Ministria për Shëndetësi mund të kërkon nga organet e Odës raport dhe informata për çështje të caktuara.
3. Odat janë të obliguara që raportet dhe informatat nga paragrafi 2. i këtij neni ti ofrojë Ministrisë për Shëndetësi në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e kërkesës, ose të informojë për arsyet për të cilat nuk është e mundur të dërgojë brenda afatit të kërkuar.
4. Odat janë të obliguara që gjerë në 31 mars të vitit vijues të dërgojnë Ministrisë për Shëndetësi raportin vjetor për vitin paraprak.

#### **Neni 46**

1. Për financimin e aktiviteteve dhe raportimet financiare të Odës duhet të zbatohen rregullat e afarizmit financiar dhe kontabilitetit në përputhje me ligjet e Kosovës.
2. Odat e profesionistëve që shfrytëzojnë mjetet e Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe mjetet tjera publike, duhet të zbatojnë dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Mjetet e shfrytëzuara auditohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU XIII**

### **AKTET E PËRGJITHSHME TË ODËS**

#### **Neni 47**

1. Odat miratojnë statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme në pajtim me statutin.
2. Statuti i Odës është akti më i lartë i Odës me të cilin në pajtim me këtë ligj më për së afërmi rregullohen çështjet:
  - 2.1. punët dhe përgjegjësitë e Odave në kuadër të autorizimeve ligjore;
  - 2.2. mënyra e ushtrimit të punës së Odave;
  - 2.3. organizimi i brendshëm i Odave;

- 2.4. përbërja e organeve të Odave;
- 2.5. mënyra dhe procedura e zgjedhjes në organet e Odave;
- 2.6. kompetencat e organeve të Odave;
- 2.7. numri i anëtarëve të organeve të Odave;
- 2.8. mënyra dhe procedura e zgjedhjes, revokimit dhe shkarkimit të anëtarëve në organet e Odave;
- 2.9. mënyra, procedura e propozimit, emërimit dhe propozimit të kryetarit të Odave;
- 2.10. përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të Odave;
- 2.11. shkelje të lehta dhe të rënda të detyrave profesionale dhe autoritetit të Odave;
- 2.12. procedura për fillimin dhe përcaktimin e përgjegjësisë së anëtarit të Odave;
- 2.13. procedura para këshillit etikë të Odës, gjyqit të nderit, shqiptimit të masave ndëshkuese dhe mënyra e realizimit të masave të shqiptuar, afatet për fillimin e procedurës si dhe çështjet tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e anëtarëve të Odave;
- 2.14. organizimi i shërbimit profesional të Odës dhe çështje tjera të rëndësishme për funksionimin e shërbimit të Odave;
- 2.15. rregullon dhe çështje tjera të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

#### **Neni 48**

Statuti i Odës miratohet dhe mund të ndryshohet me votim të së paku dy të tretave (2/3) të anëtarëve të kuvendit të Odës.

#### **Neni 49**

1. Statuti i Odës, pas miratimit nga Odat sipas neneve 47 dhe 48 i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për miratim.
2. Në rast se Ministria përgjegjëse për shëndetësi nuk deklarohet në afate prej tridhjetë (30) ditësh për projektstatutin, konsiderohet se është pajtuar me këtë projektstatut.

#### **Neni 50**

1. Odat nxjerrin edhe akte tjera të përgjithshme brenda kompetencave ligjore të Odave.
2. Procedura e miratimit të akteve të përgjithshme të Odave përcaktohet me statutin e Odave.

## **Neni 51**

1. Kuvendi i Odës miraton kodin etikë me të cilin më drejtpërdrejtë rregullohen parimet etike në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të anëtarëve të Odës.
2. Kodi etikë përcakton dhe rregullon raportet në mes të anëtarëve të Odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore si dhe raportet reciproke në mes të anëtarëve të Odës.

## **KREU XIV SHËRBIMI PROFESIONAL I ODAVE**

### **Neni 52 Kompetencat**

1. Zyra Administrative në bazë të marrëveshjes ne mes të Odave përkatëse të profesionistëve shëndetësor ushtron veprimtaritë e mëposhtme:
  - 1.1. ushtrimin e detyrave administrative dhe profesionale si:
    - 1.1.1. regjistrimin, licencimin dhe autorizimin e profesionistëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor e që nuk janë anëtare të Odave;
    - 1.1.2. mbajtjen e regjistrit të profesionistëve shëndetësor;
    - 1.1.3. aktivitete të tjera që Odat mund t'i delegojnë Zyrës Administrative;
    - 1.1.4. ushtron edhe detyra tjera administrative nga neni 9 dhe 10 i këtij ligji;
    - 1.1.5. këto detyra duhet të kryhen në bazë të kontratës për shërbime ndërmjet Odave dhe Zyrës Administrative.

### **Neni 53 Financimi fillestar dhe transferimi i personelit**

1. Ministria e Shëndetësisë do të sigurojë fondet fillestare në mënyrë që të fillojë puna e Zyrës Administrative dhe do të sigurojë pagesën për ushtrimin e detyrave publike të deleguara tek Odat siç është paraparë me ligj.
2. Ministria e Shëndetësisë do të transferoj personelin e tyre administrativ për kryerjen e detyrave publike, sipas një marrëveshjeje mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Odave.
3. Zyra Administrative do të pranojnë numrin e dakorduar të personelit që kanë punuar deri tani në Ministrin e Shëndetësisë.

**Neni 54**  
**Kontrata e shërbimeve publike dhe inspektimit administrativ**

1. Odat përkatëse shëndetësore do të bien dakord për çdo vit të ardhshëm për:
  - 1.1. planifikimi i shërbimeve që do të kryhen në vitin e ardhshëm;
  - 1.2. kompensimi bëhet në proporcion me vëllimin e shërbimeve;
  - 1.3. të drejtat tjera dhe detyrat e palëve kontraktuese.
2. Kontrata do të nënshkruhet më së largu deri në fund të Dhjetorit për vitin e ardhshëm.
3. Për vitin e parë kontrata duhet të nënshkruhet para se Zyra Administrative të fillojë së ushtruar detyra publike.
4. Inspektimi administrativ i Odave dhe Zyrës Administrative bëhet me vendim të Ministrit të Shëndetësisë. Inspektimi administrativ mund të ndërmerret vetëm me çështjet në lidhje me ushtrimin e detyrave publike të deleguara.

**Neni 55**  
**Kontratat e shërbimeve të tjera**

Zyra Administrative do të kryejë shërbime dhe detyra të tjera në emër të Odave në bazë të kontratave të shërbimeve.

**Neni 56**  
**Përgjegjësia, llogaridhënia dhe raportimi**

1. Zyra Administrative do të jetë plotësisht përgjegjëse për cilësinë e punës dhe performancës për palët kontraktuese dhe përfituesit e shërbimeve të tyre.
2. Zyra Administrative i jep llogari Odave. Ajo do të udhëheqë financat e alokuara nga Odat në mënyrë transparente për çdo Odë veçmas.
3. Për ushtrimin e detyrave publike Zyra Administrative do të raportojë në përputhje me aktet themeluese, statutin dhe kontratat e shërbimeve. Ajo do tu raportojë Odave, së paku çdo tre (3) muaj, dhe për çdo vit, deri në fund të Janarit për vitin paraprak.

**KREU XV**  
**SEKRETATI I PËRGJITHSHËM**

**Neni 57**

1. Zyra Administrative do të udhëhiqet nga Sekretari i përgjithshëm, i zgjedhur me konkurs publik.
2. Sekretari i përgjithshëm i kryen detyrat të cilat ja përcakton Oda.
3. Sekretari i përgjithshëm i Odës zgjidhet nga këshilli drejtues në bazë të konkursit publik.

**KREU XVI**  
**DISPOZITAT NDESHKUESE**

**Neni 58**

1. Me dënim me të holla në lartësinë prej pesëmijë (5.000) deri dhjetëmijë (10.000) Euro do të gjobitet Oda për këto kundërvajtjet:
  - 1.1. nëse refuzon regjistrimin e profesionistit shëndetësorë që plotëson kushtet për regjistrim të anëtarëve të Odës, gjegjësisht nëse regjistron profesionistin shëndetësorë që nuk plotëson kushtet ligjore (nën-paragrafi 1.2 i nenit 9. të këtij ligji);
  - 1.2. nëse me kërkesë të punëtorit shëndetësorë ose personit të autorizuar ligjorë nuk lëshon certifikata dhe vërtetime për të cilat Oda mban evidencën zyrtare (nën-paragrafi 1.14. i neni 9 të këtij ligji);
  - 1.3. në rast të licencimit, ri-licencimit dhe revokimit të paligjshëm të licencës në kundërshtim me ligjin.

**KREU XVII**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 59**

1. Ministria e Shëndetësisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji duhet të formojë këshillat për përgatitjen, konstituimin dhe fillimin e punës së Odave.

2. Këshillat në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e emërimit, do të përgatisin dhe miratojnë vendime statutare (Statutet e përkohshme) me të cilat caktohen çështje të rëndësishme për konstituimin e organeve të Odave, mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Odave.
3. Këshillat e Odës do të marrin vendim për shpalljen e zgjedhjeve në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e miratimit të vendimeve statutare.
4. Procedurat e kandidimit dhe zgjedhjes të anëtarëve të organeve të Odave do të bëhen në afat prej dyzetepesë (45) ditësh nga paragrafi 3. i këtij neni.
5. Konstituimi i organeve të Odave do të bëhet më së largu tridhjetë (30) ditë nga dita e zgjedhjeve të anëtarëve të kuvendit të Odës nga paragrafi 4. i këtij neni.
6. Odat e profesionistëve shëndetësorë do të fillojnë së funksionuari në afat prej katër (4) muajsh nga dita e miratimit të ligjit.
7. Odat janë të obliguara që më së largu tridhjetë (30) ditë nga dita e konstituimit të organeve të Odës të miratojnë statutet dhe aktet tjera të përgjithshme të Odës.
8. Odat do të fillojnë ushtrimin e funksioneve publike, pas miratimit të statutit, në pajtim me këtë ligj në afat më së largu gjashtë (6) muajsh nga dita e konstituimit të kuvendeve të Odës.
9. Në periudhën kalimtare tre (3) vjeçare, të gjitha aktet e Odave që kanë të bëjnë me ushtrimin e autorizimeve publike nënshkruhen edhe nga Ministri i Shëndetësisë

**Neni 60**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji nr. 04/L-150**  
**30 maj 2013**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Jakup KRASNIQI**